



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik „Zenit& Co “ sh.p.k

Adresa: Tiranë, Rruga "Myrteza Topi", Nd.18, Ap.38.

Procedura e prokurimit: Mbikëqyrja e Punimeve të Ndërtimeve dhe Rikostruksioneve të Rrjetit Ujësjellës Kanalizime për UKT sh.a(faza e 2)

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-67172-07-28-2020, loti 5 REF-67194-07-28-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Mbikëqyrja e Punimeve të Ndërtimeve dhe Rikostruksioneve të Rrjetit Ujësjellës Kanalizime për UKT sh.a(faza e 2), **Loti 5:** Mbikëqyrje të punimeve për objektin” Rikonstruksion Rrjet Ujësjellësi dhe Kanalizimi në Rrugën “Xhemal Ali Pazari

Fondi limit: 2,380,973,30(dy milion e treqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre presje tridhjetë)lekë pa tvsh

Fondi limit, loti 5: 73, 087,30(shtatëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e shtatë presje tridhjetë)lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin loti 4: 30 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 10.08.2020, ora 10:00.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Taulant sh.p.k

K61617040L

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 66,363,27(gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre presje njëzetë e shtatë)lekë pa tvsh.

2. SRP Albanian Enginerring sh.p.k

L81728013G

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 67,465(gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë)lekë pa tvsh.

3. MCE sh.p.k

L72203065K

Vlera 70,508,22(shtatëdhjetë mijë e pesëqind e tetë presje njëzetë e dy)lekë pa tvsh.

4."Zenit& Co " sh.p.k

K61731002D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 67,465,20(gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë presje njëzetë)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë:

1. Taulant sh.p.k

K61617040L

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 66,363,27(gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre presje njëzetë e shtatë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik " Taulant sh.p.k konstatoi se, Operatori Ekonomik "Taulant sh.p.k nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pasi Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga Operatori Ekonomik është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016 si dhe njoftimit të APP-së nr.5585, datë 27.07.2017).

Oferta e Operatorit Ekonomik "Taulant " sh.p.k, rezulton nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016.

Bazuar në Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 "Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim", pika 2 shprehimisht thuhet se :

"Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat mund të jenë më të ulta sesa normat minimale, të specifikuara nga ky manual"

Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanën e jashtëzakonshme, Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertës duhet ti referohet vlerësimit minimal të përlogaritur për këtë procedurë prokurimi në bazë të parashikimit në VKM nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim".

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtëzakonshme për procedurën e prokurimit me objekt" Loti V: Mbikëqyrje të punimeve për

objektin” Rikonstruksion Rrjet Ujësjellësi dhe Kanalizimi në Rrugën “Xhemal Ali Pazari ”

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “Taulant sh.p.k, është i paplotë pasi nuk ka përmbushur VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” , e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e sa më sipër.

Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

3.9.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

1(një) Inxhinier Ndërtimi

1(një) Inxhinier Hidroteknik

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Taulant” sh.p.k vëren se në përmbushje të kriterit të veçanta të kualifikimit ka paraqitur punonjësit e mëposhtëm:

D.Q(ing.mekatronik), O.P(ing.ndërtimi), A.B(ing.hidroteknik), B.M(ing.ndërtimi), S.M(ing.hidroteknik), D.Q(ing.hidroteknik), H.R(ing.hidroteknik) , N.L(ing.ndërtimi), A.T(ing.mekanik) A.F(ing.elektrik), M.Z(ing.gjeodet), R.P(arkitekt), H.P(kimist teknolog) E.Q(ing.mjedisi), E.L(ing.ndërtimi), A.L(ing.gjeolog), B.K arkitekt dhe dizajn urban, D.Q(arkitekt) shoqëruar me kontratë pune, CV, diplomë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik Taulant sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë librezat e punës çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

2.SRP Albanian Enginnering sh.p.k

L81728013G

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 67,465(gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik SRP Albanian Engineering sh.p.k konstatoi se, Operatori Ekonomik “SRP Albanian Engineering sh.p.k nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pasi Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga Operatori Ekonomik është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016 si dhe njoftimit të APP-së nr.5585, datë 27.07.2017).

Oferta e Operatorit Ekonomik “SRP Albanian Engineering sh.p.k rezulton nën minimumin e lejuar te përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016.

Bazuar në Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”, pika 2 shprehimisht thuhet se : “Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat mund të jenë më të ulta sesa normat minimale, të specifikuara nga ky manual”

Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanën e jashtëzakonshme, Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertës duhet ti referohet vlerës minimale të përlogaritur për këtë procedurë prokurimi në bazë të parashikimit në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”.

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtëzakonshme për procedurën e prokurimit me objekt” Loti V: Mbikëqyrje të punimeve për objektin” Rikonstruksion Rrjet Ujësjellësi dhe Kanalizimi në Rrugën “Xhemal Ali Pazari”.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “SRP Albanian Engineering sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” , e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e sa më sipër.

Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e përgjithshme të kualifikimit si më poshtë vijon:

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi _____ aktiv).

Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Referuar ekstraktit të regjistrimit tregëtar të paraqitur të operatorit ekonomik pjesëmarrës rezulton se kjo shoqëri në cilësi të administratorit ka caktuar z. B.K , z.F. E ndërsa në cilësinë e ortakëve të shoqërisë rezulton të jetë z. B.K si dhe shfaqet ortak dhe personi juridik Schneider & Partner Ingenieur - Consult GmbH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik “SRP Albanian Engineering” shpk ka dorëzuar shtojcën 4 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme nga ku rezulton se ka deklaruar z.B.K, Z.F.E por jo të gjithë ortakët e saj përkatësisht Schneider & Partner Ingenieur - Consult GmbH.

KVO gjykon se formati standart i shtojcës 4 ”Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, është i tillë që kërkon domosdoshmërisht citimin e cilito anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, të operatorit ekonomik të cilët nuk duhet të jenë ose të kenë qënë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

KVO citon se shtojca 4 “Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” nuk lë vend për konfuzion për mënyrën e plotësimit të saj dhe akoma më tej këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikmëri në përputhje me formatin e miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik. Ju bëjmë me dije se në shtojcën e kriterëve të përgjithshme formati I miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik kërkon që të citohen të gjithë emrat konkretë të të gjithë subjekteve që kanë rol vendimarrës pranë shoqërisë përkatëse duke përfshirë dhe subjektet juridike të cilat rezultojnë në cilësinë e ortakut.

KVO gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt prokurimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese.

Për këtë shkak shtojca 4 e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar.

Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së.

3. MCE sh.p.k

L72203065K

Vlera 70,508,22(shtatëdhjetë mijë e pesëqind e tetë presje njëzetë e dy)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kushtet e përgjithshme të kualifikimit si më poshtë vijon:

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP².

Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Referuar ekstraktit të regjistrimit tregëtar të paraqitur të operatorit ekonomik pjesëmarrës rezulton se kjo shoqëri në cilësinë e administratorit ka caktuar z. P.M ndërsa në cilësinë e ortakëve të shoqërisë rezulton të jetë z.P.M edhe z.B.M .

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik “MCE ” shpk ka dorëzuar shtojcën 4 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme nga ku rezulton se ka deklaruar z. P.M por jo të gjithë ortakët e saj përkatësisht z.B.M.

KVO gjykon se formati standart i shtojcës 4 "Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme", është i tillë që kërkon domosdoshmërisht citimin e cildo anëtari të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, të operatorit ekonomik të cilët nuk duhet të jenë ose të kenë qënë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

KVO citon se shtojca 4 "Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme" nuk lë vend për konfuzion për mënyrën e plotësimit të saj dhe akoma më tej këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikmëri në përputhje me formatin e miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik.

Ju bëjmë me dije se në shtojcën e kritereve të përgjithshme formati I miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik kërkon që të citohen të gjithë emrat konkretë të të gjithë subjekteve që kanë rol vendimarrës pranë shoqërisë përkatëse .

KVO gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt prokurimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese.

Për këtë shkak shtojca 4 e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar.

Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuara nga neni 42 i LPP-së.

Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

3.6.Një punësim mesatar i të paktën 4 (kater) personave, për periudhën Janar 2020 – Qershor 2020 të vërtetuar me;

3.7.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar 2020 – Qershor 2020.

3.8 List pagesat e punonjësve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2020 – Qershor 2020.

(Nëse operatori ekonomik oferton per lote te vecanta, nr.i punonjësve duhet ti korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumës se loteve qe oferton)

Për të dëshmuar përmbushjen e kushtit të kërkuar në DST operatori ekonomik MCE sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik vërtetim për numër punonjësish nr. T02685708, datë 07.08.2020 vërehet se numri mesatar i punonjësve për periudhën Janar 2020-Qershor 2020 rezulton të jetë 9,5 punonjës.

Duke iu referuar faktit se operatori ekonomik MCE sh.p.k është pjesëmarrës në 5 lotet e zhvilluara nga AK UKT sh.a dhe numri total i punonjësve të 5 loteve është 30 punonjës KVO

gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës MCE sh.p.k nuk disponon numrin e nevojshëm për ekzetutimin e kontratave nëse do të shpallej fitues.

Theksojmë se kriteri i kërkuar nga AK ka qënë i qartë dhe nuk lë vend për paqartësi, pra nëse operatori ekonomik do të ofertonte për më shumë se 1 lot atëherë ai duhet të plotësonte shumën e loteve që oferton.

KVO thekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Zenit& Co " sh.p.k se oferta e paraqitur, prej me një vlerë të përgjithshme prej 67,465,20(gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë presje njëzetë)lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a, Drejtoria e Prokurimeve sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60(gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **11.08.2020**

Ankesa: JO